



Presidenti i Republikës viziton Kompleksin Spitalor Universitar ZKM

## JAM BAJRAMI, PO VIJ T'JU VIZITTOJ

Një vizitë informale, pothuajse familjare ishte ajo e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj. Njoftuar vetëm dy ditë më parë, më datë 10 korrik ai mbërriti në Kompleksin e Tiranës me dëshirën e madhe për të parë nga afër Universitetin që e njihnte tashmë dhe mbi të gjitha Spitalin e ri. Një vizitë prej dy orësh, pa nxitim dhe shumë e motivuar.

Presidenti duke qenë dhe vetë mjek, u ndje menjëherë si në shtëpinë e tij, mes kolegëve dhe ambienteve të kujdesit shëndetësor. Dëgjoji fjalën e mirësearchjes dhe përditësimet mbi realitetin e Fondacionit "Zoja e Këshillit të Mirë". Në fjalimet e tij dëshiroi të nënvizonte kontributin e çmuar të dhënë në zhvillimin e veprimtarive universitare dhe spitalore në Shqipëri, një tokë e etur për dije dhe praktika të mira, për t'u ndjerë plotësisht e integruar në familjen e madhe evropiane. Gjatë vizitës së reparteve spitalore dhe "qendrës së diagnostifikimit" të spikatur, të kompletuar me pajisje mjekësore moderne, Presidenti shprehu kënaqësinë e madhe për realizimin e saj, e cila i ka rrënjët në dëshirën e Nënë Terezës që Toka e Shqiponjave



të pajiset me një spital të përshtatshëm për kohën. Nisma, siç dihet, u ndërmor nga Komuniteti i At Montit, që themeloi Fondacionin "Zoja e Këshillit të Mirë" në vitin 1993. Presidenti Begaj theksoi progresin e jashtëzakonshëm që është bërë, nga një Poliklinikë te Rruga Kavajës tek Spitali i sotëm. Presidenti i Fondacionit, fr. Ruggero Valentini dhe rektori i Universitetit, prof. Leonardo Palombi, nënvizuan pikat e forta të Kompleksit universitar-spitalor, duke përmendur gjithashtu nevojën për mbështetjen e qeverisë për të mbajtur të larta nivelet e cilësisë dhe për të vënë në dispozicion iniciativat për të gjithë shoqërinë shqiptare.

Vizita e detajuar në Spital u drejtua nga drejtori i përgjithshëm, fr. Natalino Poggi dhe drejtori mjekësor prof. Fabian Cenko. Gjatë vizitës u dëgjuan deklarata të rëndësishme: "askush sot nuk duhet të ndihet i huaj", "ose do të ndërtojmë të ardhmen së bashku ose nuk do të ketë të ardhme", bashkëjetesa e shëndetshme kërkon që të gjithë "të mos mbajnë anë, por të marrin pjesë". Vizitën e shijuan të gjithë të pranishmit, madje edhe studentët, të fokusuar mendërisht dhe emocionalisht nga provimet që janë duke dhënë, sezoni i fundit para pushimeve.



## NJË SPITAL ME SHPIRTIN E NJË POPULLI

Kjo është një nismë e veçantë për Shqipërinë, pasi spitali ZKM është fryt i një projekti të krijuar nga synimet më autentike të subjekteve të ndryshme: Qeverisë Shqiptare, Kishës Katolike, Nënë Terezës, Komunitetit të At Montit. Në kohët më të fundit pas lirisë së gjetur, në Shqipëri është krijuar një sinergji mes planifikimit të shëndetit publik, bamirësisë së krishterë, vitalitetit të karizmave, pjesëmarrjes qytetare, deri në vlerësimin e aftësive profesionale dhe morale të individëve. Ajo çfarë shohim sot është një spital tashmë i rrënjosur në këtë vend, i cili nuk është realizim i një oligarku privat që ndjek qëllime legjitime ekonomike por përkundrazi ka diçka që shkon më tej. Vendimi i Komunitetit të At Montit për të krijuar një Fondacion, Jofitimprurës dhe sipas ligjit shqiptar (në vitin 1993!), kishte synimin të shprehte shpirtin e një populli, duke hedhur rrënjë në territorin e tij dhe duke vepruar në kuadrin e ekonomisë civile dhe solidarë. Një organizatë, pra, e cila riinveston ekskluzivisht çdo të ardhur për të arritur objektivat sociale të formimit dhe të kujdesit, duke bërë në këtë mënyrë të ndihet prania miqësore e saj, një e Mirë e Përbashkët e vërtetë. Sot në Shqipëri operohet në një treg të lirë, me eksese që janë të dukshme: në këtë kontekst ekonomik, qytetarët e kanë të vështirë ta besojnë se një spital privat mund të kryej aktivitetin e tij pa pasur qëllime fitimprurëse... Por funksionon pikërisht kështu për Fondacionin Jofitimprurës, pasi çdo e ardhur e mundshme (dhe e dëshirueshme!) duhet të dërgohet për zhvillimin e qëllimeve të përcaktuara në Statut. Qëllime të cilat bazohet ky spital.



Kjo do të thotë se Fondacioni "Zoja e Këshillit të Mirë" promovon vërtet përmirësimin e vendit, veçanërisht në fushat e arsimit dhe shëndetësisë. I përket Shqipërisë, falë edhe frymëzimit të saj të krishterë, që ka një ndjeshmëri të dukshme sociale. Prandaj, nëse ti dhe familjarët e tu kërkon shërbime mjekësore në Spitalin ZKM, do të jeni pjesëmarrës në një projekt të rëndësishëm për vendin, efektet pozitive të të cilit i ndajnë të gjithë.

Një institucion shëndetësor me rëndësi të madhe

## NË HAPAT E NËNË TEREZËS



Spitali Katolik "ZKM" është një institucion i rëndësishëm shëndetësor, i ngritur në përmbushje të vullnetit të Nënë Terezës, e cila ka ideuar, i ka dhënë emrin, ka kërkuar mbështetje dhe ka bekuar të gjithë ata që u angazhuan në ndërtimin dhe mbarëvajtjen e këtij spitali në Shqipëri. Spitali Katolik u ndërtua nga Kongregata e Bijve të Zojës së Papërlyer me qendër në Romë, për të rritur dhe përmirësuar shërbimin shëndetësor për popullin shqiptar. Nën frymëzimin e Shenjtërisë së Tij Papa Gjon Pali i II-të dhe Shenjtërisë së Saj Nënë Tereza e Kalkutës, në vitin 1993 në Shqipëri u themelua "Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë", një nismë e Kongregatës së Bijve të Zojës së Papërlyer.

Fondacioni i përkushtohet shëndetit dhe arsimit. Në funksion të këtyre qëllimeve të mëdha, janë ndërtuar disa struktura shëndetësore si poliambulanca, laborator i analizave biokimike, farmacia, klinika e odontoiatrisë, qendra e fizioterapisë. Ndërtimi i Spitalit Katolik "ZKM" ka shënuar finalizimin e një faze shumë të rëndësishme të angazhimit të Fondacionit "ZKM" në Shqipëri.



# BURSAT E STUDIMIT / PAPAL FOUNDATION

Papal Foundation me qendër në Vatikan, nëpërmjet Nuciaturës Apostolike të Selisë së Shenjtë në Tiranë, ka vënë në dispozicion një fond i cili do të përdoret për të mbështetur me bursa studimi ata që duan të studiojnë në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" të Tiranës.



Bursat universitare që jepen nga Papal Foundation janë shprehje e kujdesit të veçantë të Shenjtërisë së Tij Papa Françeskut për të rinjtë e Shqipërisë. Vlerësimi i kandidatëve bazohet në kriteret e transparencës dhe barazisë.

## Erasmus +

# PROGRAMI EVROPIAN PËR ARSIMIN

Universiteti ynë ka arritur me sukses të marrë Kartën Erasmus për Arsimin e Lartë, për periudhën 2021-2027, akreditim i dhënë nga Komisioni Evropian për Institucionet e Arsimit të Lartë që mund të marrin pjesë aktive në programet e shkëmbimit dhe bashkëpunimit evropian dhe ndërkombëtar në kuadër të Erasmus+, Programit evropian për Arsim, Formim, Rini dhe Sport.

Ky rezultat është një arritje domethënëse për universitetin tonë i cili pasqyron përkushtimin dhe punën që kemi treguar ndër vite në promovimin e standardeve ndërkombëtare të arsimit dhe bashkëpunimit akademik.

Karta Erasmus për Arsimin e Lartë përcakton parimet e përgjithshme të cilësisë për menaxhimin e aktiviteteve të programit Erasmus+ dhe siguron që universiteti ynë do të respektojë kriteret rigorozë për sa i përket njohjes së krediteve, transparencës, përfshirjes, barazisë dhe cilësisë së përvojës arsimore dhe administrative dhe se si ne synojmë t'i përmbahemi parimeve të reja të Programit, pra Gjithëpërfshirjes, Digjitalizimit, Qëndrueshmërisë së gjelbër dhe Angazhimit Qytetar.



Marrja e Kartës Erasmus i mundëson universitetit tonë të vazhdojë të marrë pjesë në një gamë të gjerë aktiviteteve të ofruara nga programi Erasmus+, ndër të cilat: Shkëmbimi i Studentëve dhe Personelit, Partneritetet Strategjike (krijimi dhe forcimi i bashkëpunimeve me institucione akademike dhe organizata nga e gjithë Evropa, duke promovuar projekte inovative dhe duke ndarë praktika të mira) dhe Projektet e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (që synojnë përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe formimit, duke kontribuar në modernizimin dhe ndërkombëtarizimin e aktiviteteve tona akademike).

Një prani e gjallë dhe kapilare në vend

# KOMISIONI KOMBËTAR I EDUKIMIT KATOLIK NË SHQIPËRI



Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar

Misioni kryesor i KKESH është të promovojë përmbushjen me efektivitet të lirisë së arsimit si një kusht themelor për funksionimin e një shoqërie demokratike, në përputhje me të drejtat e liritë themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Deklarata, Konventa dhe protokollet shtesë të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Profesionist për një ditë

## UKZKM ËSHTË MUNDËSIA PËR TË ZGJEDHUR PROFESIONIN E JETËS



Dita më e bukur për një të ri është padyshim kur nis të praktikojë profesionin që ka ëndërruar gjithmonë. Prandaj, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ka ofruar një mundësi të dobishme për të gjithë të diplomuarit që kërkojnë përgjigje në lidhje zgjedhjet që duhet të bëjnë për jetën e tyre.

Shumë të rinj nga qytete të ndryshme të Shqipërisë erdhën në Kampusin tonë dhe vizituan kompani të suksesshme në tregun shqiptar, duke u përpjekur të bëhen ekonomistë, arkitektë, fizioterapistë, farmacistë dhe infermierë për një ditë.

Çdo vit, kampusi ynë është dëshmon histori suksesi të studentëve që kanë ndjekur studimet në këtë Universitet.



Të diplomuar në Mjekësi



## NJË SFIDË E FITUAR NË SHKENCAT MJEKËSORE

Shumë të rinj, familjarë, miq dhe kolegë të studentëve tanë të Mjekësisë mbushën sallën Aula Magna. U përmbyll me sukses dhe me shumë emocione pranë Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" një rrugëtim i gjatë, i vështirë, plot sfida, por shumë i bukur dhe emocionues. Studentët u diplomuan në Mjekësi, duke marrë në këtë mënyrë kualifikimin e mjekut. Ne në UKZKM jemi shumë krenar për ju dhe e kemi ndjekur rrugëtimin tuaj me vëmendje dhe përkushtim.

I urojmë fat mjekëve tanë të rinj: **Teresa Cristofaro, Treisi Islami, Ledia Kodraçaj, Argjend Kosiqi, Klarita Luka, Enxhi Qeli, Nicola Rizzo, Esmeralda Skana, Alessia Zadrime, Kristela Pepa.**



## ZYRA E PRANIMEVE PRANË UKZKM

Zyra e Pranimeve të Studentëve ofron një shërbim informacioni dhe mirësearchjeje për të gjithë ata që janë të interesuar të studiojnë në Universitetin Katolik ZKM. Shërbimet e ofruara janë informacione të përgjithshme dhe mbështetje për programet e studimit, taksat dhe kontributet; procedurat e pranimit, transferimit të studimeve dhe program të dytë studimi, për regjistrimin online të kandidatëve në Portalin e pranimeve; organizon dhe menaxhon procedurën e pararegjistrimit që përfshin regjistrimin në testimin e pranimit dhe kryerjen e pagesës së tarifës së përcaktuar për pjesëmarrje në testimin e pranimit; menaxhon grupin e të interesuarve që kanë paraqitur "Shprehje Interesi" dhe i dërgon pjesëmarrësve të këtij grupi, njoftimet e nevojshme për procedurat e pranimit.



### Kontakte

Hyrja Qendrore

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".

info@unizkm.al +355 4 2273290

Fax: +35542243291

Fundi i kurseve të studimit në UKZKM

## NJË VIT TJETËR ANGAZHIM PËR STUDENTËT TANË

Çdo vit që kalon Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" rritet gjithnjë e më shumë, bashkon studentë nga Shqipëria dhe e gjithë Evropa, u jep të rinjve mundësinë të jetojnë një eksperiencë të plotë akademike dhe njerëzore.



Çdo vit kampusi ynë dëshmoni histori sukcesi të studentëve tanë në programet e studimit Mjekësi, Odontoiatri dhe Proteza Dentare, Infermieristikë, Fizioterapi, Farmaci, Ekonomi dhe Arkitekturë.

Kemi 20 vjet që kemi revolucionarizuar sistemin universitar në Shqipëri, duke udhëhequr me standardet e njohura si sukses nga e gjithë bota, jetën akademike dhe kërkimore në vend.

## STATISTIKA QË FRYMËZOJNË

Të diplomuarit tanë të UKZKM janë një target i rëndësishëm i Zyrës së Orientimit për Studime dhe Punë. Me përfundimin e karrierës akademike, nuk përfundon marrëdhënia me universitetin. Ne përqipemi të promovojmë dhe inkurajojmë të rinjtë për të hyrë në tregun e punës. Me një total prej 2865 të diplomuar, 1813 janë femra dhe 1052 meshkuj. Sipas bazës së



të dhënave, nga këta 2355 të diplomuar, 103 janë aktualisht të papunë, ndërsa 2252 janë të punësuar. 4% e të papunësuarve përbëhen kryesisht nga të sapodiplomuar në Mjekësi, të cilët janë në pritje të provimit të shtetit, ose nga ata që vazhdojnë studimet e mëtejshme (Master shkencor). Gjithashtu, duhet specifikuar se me marrjen e një diplome të sistemit universitar italian dhe marrjen e kualifikimit të profesionit nëpërmjet Provimit të Shtetit, të diplomuarit e këtij viti akademik ashtu si në vitet e mëparshme, kanë gjetur mundësi punësimi si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj: Gjermani, Itali, Angli, SHBA, Zvicër etj. Shumica apasur parasysh njohjen ndërkombëtare të Universitetit tonë, ne kemi një përqindje të lartë studentësh nga Italia dhe vende të ndryshme të botës.

Biblioteka e Universitetit kushtuar Fratel Paolo Ruatti-t

## LIBRAT, MJEKËSI PËR SHPIRTIN

Kampusi i UKZKM është i hapur gjatë gjithë vitit, po ashtu edhe Biblioteka e cila është pjesë përbërëse e tij. Çdo ditë, edhe gjatë muajve të nxehtë të verës, studentët tanë kanë mundësinë të vizitojnë me qetësi bibliotekën. Mijëra tituj librash akademikë, kërkimesh shkencore, literaturë profesionale bashkëkohore, ese shkencore janë në dispozicion të studentëve që përballen me provimet dhe nevojën për të fituar njohuritë më të gjera.



Nën kujdesin e punonjësve të bibliotekës, çdo titull libri është një thesar i shfletuar shumë, duke ofruar një dimension të plotë shërbimi në kampusin tonë universitar. Biblioteka është e pasur me literaturë nga mjekësia, arkitektura, biznesi, infermiera, odontoiatria dhe fizioterapia, duke ofruar mundësi të shumta për studentët dhe të diplomuarit e UKZKM për të qenë konkurrues në sferën akademike.

Personazh ZKM



## FREDI DRAGUSHA

Fredi punon pranë zyrës së marketingut si dizajner grafik dhe multimedial në UKZKM. Fredi u bë pjesë e rrugëtimit të Fondacionit ZKM në vitin 1995 si vullnetar. Me kalimin e viteve ai është bërë pjesë integrale e stafit tonë mbështetës në Kampusin Universitar. Fredi Dragusha është diplomuar në Universitetin e Arteve Pamore të Tiranës për Grafikë dhe gjithashtu është specializuar në Saronno në Itali në Institutin "Padre Monti". Fredi gjithashtu ndihmon studentët në përgatitjen e materialeve të shumta të zhvilluara gjatë studimeve të tyre. Gjithmonë i gatshëm për të bashkëpunuar, i urojmë Fredit vazhdimin e rrugëtimit të tij bujar dhe kompetent.



## NJË UNIVERSITET I HAPUR NË BOTË

Ndiqui në linkun e mëposhtëm lajmin e përgatitur nga media italiane mbi Programin e Studimeve të Infermieristikës në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe mbi standardet evropiane që ne ofrojmë. Pak javë më parë, gazetarët e RAI-t vizituan kampusin universitar dhe filmuan disa orë leksionesh gjatë jetës universitare të studentëve tanë.



Tirana - Albania

### Emergenza infermieri. Le cooperative sociali trentine li reclutano a Tirana

Sono già 30 quelli inseriti nelle Rsa, altri arriveranno a luglio. In Albania concorrenza spietata per "ingaggiarli" mentre si propone che la sanità trentina valuti l'opportunità di valorizzare questa esperienza

[https://www.rainews.it/tgr/trento/video/2024/06/emergenza-infermieri-65148263-968d-4f02-8d88-55aa4175527e.html?wt\\_mc=2.www.wzp.rainews](https://www.rainews.it/tgr/trento/video/2024/06/emergenza-infermieri-65148263-968d-4f02-8d88-55aa4175527e.html?wt_mc=2.www.wzp.rainews)



Blue Box te Piramida e Tiranës

## ARKITEKTURA: ATRAKSIONI ITALIAN

Uzhvillua në Blue Boz te Piramida e Tiranës, takimi i katërt i ciklit të konferencave TALKS@UNIZKM\_2024 ARKITEKTURA BASHKËKOHORE ITALIANE: Renato Capozzi dhe Federica Visconti – "Projekte për qytetin", nismë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë". Ky aktivitet ishte pjesë e Javës Italiane në bashkëpunim me Ambasadën Italiane në Tiranë dhe Institutin Italian të Kulturës.



Bisedimet u fokusuan në ilustrimin dhe përshkrimin e disa projekteve për qytetin – të krijuara me rastin e konkurseve apo konsultimeve dhe kërkimeve akademike – të cilat dëshmojnë për një qëndrim që ndërthur vazhdimësinë dhe/ose mos vazhdimësinë e saktë e qytetit historik italian, por edhe një dimension më të gjerë.



## EKSPERIENCA E FEDERICA-S



**K**jo vajzë e re quhet Federica Licchelli. Prej disa javësh ajo ndodhet në Shqipëri për të ndjekur rrugëtimin e saj akademik në Universitetin tonë Katolik “ZKM” në kuadër të programit Erasmus+. Jo vetëm studentët tanë shkojnë jashtë vendit, por dhe studentë nga Bashkimi Evropian vijnë tek ne, dhe kjo është një vlerë e shtuar për UKZKM.

*Eksperiencia ime këtu në Shqipëri, tregon Federica, ka sjellë vetëm gjëra pozitive. “Më pëlqente të provoja një tjetër realitet universitar, ndryshe nga ai që ndiqja në Itali. Universiteti i ofron të gjitha mjetet e nevojshme për t’u thelluar dhe mësuar sa më mirë. Ndjek programin e odontoiatrisë dhe protezës dentare dhe në muajt e kaluar këtu në Tiranë, përveçse kam ndjekur leksionet, kam mundur të bëj edhe disa praktika shumë të mira, si psh endodoncia kirurgjikale. Për sa i përket qytetit, jam dashuruar me të”.*

Jemi çfarë hamë

## EDUKIMI I BREZAVE TË RINJ

**N**ë oborrin e Ambasadës italiane në Tiranë gjendet një kopsht urban, i cili synon të promovojë kulturën e dietës ushqimore mesdhetare, të pasur me fruta dhe perime. Në kohët e teknologjisë është e rëndësishme të edukojmë brezat e rinj me kulturën e ciklit të plotë ushqimor të shëndetshëm, duke promovuar gjithashtu edhe hapësirat e gjelbërta në qytetet tona.

Të rinjve u foli Ambasadori Italian në Tiranë SH.T Fabrizio Bucci dhe Profesoresha Angela Andreoli, nutricioniste e njohur e Universitetit Katolik “ZKM” dhe e universitetit “Tor Vergata” të Romës, si dhe Presidente e Shoqatës Shqiptare të Shkencave të Ushqyerjes (Albanian Society of Nutrition Science).


Profesoresha Andreoli u shpjegoi të rinjve rëndësinë që ka ushqimi i shëndetshëm për jetën dhe trupin e tyre, duke i inkurajuar të zgjedhin sa më shumë fruta dhe perime në dietat e tyre ditore të përditshme.



Vëllai është i bukur

## VËLLAZËRIA QË NA PËLQEN

**D**el botimi i dytë i një libri që tregon historinë e Luigj Montit dhe shokëve të tij, djem të dashuruar me vëllazërinë. Dhe për këtë arsye u burgosën për dy muaj e gjysmë. Është një histori e vërtetë, e treguar nga vëllat Ruggero për të nxjerrë në pah protagonizmin e të rinjve në ndërtimin e një shoqërie vëllazërore. Papa Françesku shkruan: “Një histori e mirë është në gjendje të kapërcejë kufijtë e hapësirës dhe kohës” dhe “duke u zhytur në histori, ne mund të gjejmë arsye heroike për të përballuar sfidat e jetës”. Teksti u drejtohet edhe të rriturve, të cilët janë edukatorë për një jetë të mirë. Në dyqindvjetorin e lindjes së At Montit, mund të jetë interesante të rizbulohet jeta e tij rinore. Librin do ta gjeni në Bibliotekën e Universitetit, me gjysmën e çmimit. (Shtëpia Botuese “Ancora”, Milano, korrik 2024, 96 faqe, 9 €).





# TAKIMET E ARDHSHME

## Cammino MONTIANO

Tra terra e cielo  
in Lombardia



**22** luglio 2024 ore 7  
da Bovisio-Masciago a Saronno  
Cesano Maderno, Ceriano Laghetto, Cogliate

**BICENTENARIO DELLA NASCITA DEL BEATO LUIGI MONTI**  
 ■ Il percorso di 15 km inizia alla Casa natale in Bovisio Masciago (Via Marconi 34)  
 ■ Pranzo al sacco  
 ■ Arrivo all'Istituto Padre Monti di Saronno

Per contatti:  
 com.laudatosibm@gmail.com  
 www.spuntidifuturo.it



"QUI È COMINCIATO TUTTO"



## Roots of War & Establishment of a Lasting Peace

September 3-10<sup>th</sup> 2024



**SUMMER SCHOOL**  
9<sup>th</sup> edition

<https://unizkm.al/categories/cespic/posts>



UNIVERSITETI KATOLIK  
ZOJA E KËSHILLUT TË MIRË



ALMA MATER STUDIORUM  
UNIVERSITÀ DI BOLOGNA

## MASTER IN FINANCIAL & RISK MANAGEMENT



## Madre Teresa di Calcutta

*Il cammino semplice*

5 Settembre 2024  
Aula Magna, UCNSBC



## PADRE LUIGI MARIA MONTI

BICENTENARIO




1825-2025 NASCITA  
BEATO LUIGI MARIA MONTI

"QUI È COMINCIATO TUTTO"



International Executive/II Level  
Master Degree

## Restoration conservation and management of architectural heritage



Università degli Studi di Firenze  
Dipartimento di Architettura

Università Cattolica  
"Nostra Signora del Buon Consiglio"

Università di Argirocastro  
"Eqrem Çabej"